



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.164/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.04.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Modifikimi i dokumenteve të procedurës së ankandit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Bashkia Shkodër shet me procedurë ankandi aksionet e Klubit të Futbollit “VLLAZNIA” SHA, në masën 100%.*”, me vlerë fillestare 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.03.2021, nga autoriteti shitës Bashkia Shkodër.

Ankimues: “Colosseo Construction” SHPK
Lagjja “3 Heronjtë”, Rruga Marin Bicikemi,
Shkodër

Autoriteti Shitës: Bashkia Shkodër
Rruga 13 Dhjetori, nr. 1, Shkodër

Baza Ligjore: Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin

e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga kandidati blerës ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë ankandi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në 42 të ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “*Për Ankandin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Kandidati blerës ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit shitës, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e ankandeve, që shqyrton ankesat për procedurat e ankandit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “*Për Ankandin Publik*”, i ndryshuar”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit shitës dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.02.2021, është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 21, faqe 348 procedura e ankandit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Bashkia Shkodër shet me procedurë ankandi aksionet e Klubit të Futbollit “VLLAZNIA” SHA, në masën 100%.*”, me vlerë fillestare 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.03.2021, nga autoriteti shitës Bashkia Shkodër.

II.2. Referuar dokumentacionit të administruar nga KPP, nëpërmjet ankesës të paraqitur nga kandidati blerës ankimues, konstatohet se është bashkëlidhur dokumenti bankar i datës 25.02.2021,

i cili vërtetohet kryerjen e pagesës nga ana e këtij të fundit, për pajisjen me dokumentet standarde të ankandit objekt ankimi.

II.3. Në datën 01.03.2021 është depozituar ankesë pranë autoritetit shitës, Bashkia Shkodër, nga ana e kandidatit blerës “Colosseo Construction” SHPK, me anë të së cilës kërkon modifikimin e dokumenteve të procedurës së ankandit objekt ankimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

- *Më datë 25.01.2021 kemi paraqitur kërkesën për të blerë dokumentet e ankandit sipas kushteve të vendosura paraprakisht nga ana juaj. Po ashtu kemi bërë edhe pagesën përkatëse dhe njëkohësisht jemi pajisur me dokumentet e ankandit. Gjatë përgatitjes së dokumentacionit të kërkuar nga ana juaj konstatojmë se janë vendosur kritere për kualifikim që janë të paqarta dhe njëkohësisht në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi.*
- *Bashkia Shkodër në cilësinë e aksionerit të vetëm të klubit të futbollit Vllaznia sha bën administrimin e jashtëzakonshëm të tij nëpërmjet vendimmarrjeve përkatëse të Këshillit të Bashkisë si aksioner dhe ortak de juro dhe de facto i klubit të futbollit Vllaznia SHA. Në përputhje me kompetencat e tij Këshilli i Bashkisë Shkodër më datë 27.11.2020 nëpërmjet vendimit nr.54 ndër të tjera ka vendosur:*
- *Miratimin për shpalljen për shitje të 100% të aksioneve që Bashkia Shkodër zotëron si aksionere e vetme në shoqërinë Klubi i Futbollit Vllaznia.*
- *Në pikën 3 të këtij vendimi është përcaktuar qartë se : Forma e shitjes së aksioneve që zotërohen nga Bashkia Shkodër në shoqërinë Klubi i Futbollit Vllaznia të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese procedurë e hapur standard e ankandit sipas dokumenteve tip të ankandit bashkëngjitur këtij vendimi.*
- *Duke ju referuar kësaj vendimmarrje e cila ka karakter detyrues për Bashkinë Shkodër rezulton se Këshilli i Bashkisë e ka të përcaktuar qartë procedurën që duhet të ndiqet për shitjen e aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia, por nga ana tjetër ka përcaktuar qartë edhe kriteret që duhet të vendosen paraprakisht për çdo subjekt të interesuar për blerjen e këtyre aksioneve.*
- *Në referim të kësaj vendimmarrjeje dhe në referim të përcaktimeve ligjore për ankandin publik procedurën e hapur të zhvillimit të tij rezulton që Bashkia Shkodër ka vendosur kritere në kundërshtim me ligjin diskriminuese dhe njëkohësisht për të favorizuar eventualisht ndonjë subjekt të interesuar.*
- *Neni 29 i ligjit 9874 datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar përcakton qartësisht se cilat janë kriteret që duhet të vendosen në procedurën e hapur të ankandit publik dhe konkretisht:*
Neni 29

Autoriteti shitës kualifikon në procedurat e ankandit çdo kandidat ose ofertues vetëm kur paraqet: a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet standarde të ankandit;

b) vendimin e gjykatës për fitimin e personalitetit juridik;

c) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

ç) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.

2. Autoriteti shitës, kur kërkohet informacion për ofertuesin rezident në një shtet të huaj, mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve përkatëse.

Ky parashikim ligjor i bërë në përputhje me natyrën dhe qëllimin e ankandit publik është determinant për përcaktimin e kushteve që duhet të ketë një subjekt për të marrë pjesë në një ankand publik procedurë e hapur.

Ndërkohë që Bashkia Shkodër vendos kritere ekstremisht të ekzagjeruara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore duke mos pasur asnjë arsyetim logjik dhe ligjor për vendosjen e tyre.

Të gjitha kriteret e vendosura nga Bashkia Shkodër bien ndesh me qëllimin që ka ligji për ankandet publike.

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për realizimin e shitjes publike nëpërmjet procedurës së ankandit nga autoriteti shitës dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të pjesëmarrësve në procedurën e ankandit.

2. Qëllime të këtij ligji janë:

a) rritja e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e ankandit publik, të kryera nga autoritetet shitëse;

b) nxitja e pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik;

c) nxitja e konkurrencës ndërmjet blerësve;

ç) sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e ankandit publik;

d) sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e ankandit publik.

- Si pasojë e kriterëve të vendosura nga ana juaj, ajo që konstatohet menjëherë është shkelja e nenit 1/c për nxitjen e konkurrencës nëpërmjet subjekteve të interesuara pasi po të ishte bërë një verifikim paraprak në organet tatimore se cilat janë dhe sa është numri i bizneseve që kanë realizuar sponsorizime (përfshijto ato që janë ortak ose të angazhuar në një ekip tjetër të futbollit shqiptar) është shumë i vogël për të mos thënë nuk ekziston fare.
- Vendosja e këtyre kriterëve nuk siguron trajtim të barabartë për të gjithë pasi favorizon në mënyrë direkte subjektet e preferuar nga ana juaj.

- Në pikën q të kërkesave për kualifikim është kërkuar që subjekti pjesëmarrës duhet të ketë kontrata transaksione dhe eksperiencë në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive , shoqërive sportive të futbollit apo sporteve të tjera të ngjashme, minimalisht në tre vitet e fundit pjesë e veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB.
- Nëse është përcaktuar shprehja minimalisht normalisht që të sqarohet edhe e kundërta e saj. Po maksimalisht deri kur është e lejuar dhe e pranueshme për ju që të ekzistojë një eksperiencë e ngjashme. Pasi në interpretim literal të fjalës Minimalisht i bie që të mos ketë ndonjë kufizim për periudhën se kur duhet të jetë realizuar eksperiencë e ngjashme.
- Po ashtu është lënë në mënyrë evasive “përcaktimi i sporteve të ngjashme” duke mos sqaruar se cilin prej sporteve do e vlerësojë si të ngjashme Bashkia Shkodër apo thjesht do e bëjë vlerësimin vetëm mbi baza subjektive duke favorizuar subjektin e saj preferencial.
- Është kërkuar që të paraqiten dokumentacione sponsorizimi në përputhje me legjislacionin tatimor ndërkohë që legjislacioni tatimor e kushtëzon ruajtjen e dokumenteve kontabël tatimor për një periudhë 5-vjeçare. Duke sjellë përjashtimin automatik të subjekteve që kanë kryer sponsorizime në periudha më të largëta se 5 vite.
- Përpilimi i dokumenteve është bërë në mënyrë tendencioze duke lënë përshtypje sikur janë vendosur në dëm të ndonjë subjekti dhe jo në dobi të subjekteve të interesuara.
- VKM nr.308 datë 10.04.2013 e ka të përcaktuar qartë dh) kriteret dhe kushtet për pjesëmarrje kualifikim dhe vlerësim të ofertës: Ky formular përmban listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti shitës, për të drejtën për të marrë pjesë në procesin e ankandit, në përputhje me nenin 29 dhe 30 të LAP-së. Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin, për të gjitha sa u thanë më sipër, një deklaratë me shkrim. Vërtetimi i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) do të jetë i barasvlershëm me vendimin për fitimin e personalitetit juridik, përcaktuar në nenin 29 të LAP-së. Kriteri bazë i vlerësimit do të jetë oferta me çmimin më të lartë.
- Edhe në këtë përcaktim ligjor kuptohet qartë se qëllimi i ankandit ka të bëjë vetëm me njohjen e personalitetit juridik të subjektit pjesëmarrës , ligjshmërinë e aktivitetit të tij dhe vendos si bazë të shpalljes fitues ofertën me çmim më të lartë.
- Nuk është dhënë as ndonjë sqarim në lidhje me faktin se çfarë do të bëhet me detyrimet eventuale që mund të ketë shoqëria Klubi i Futbollit Vllaznia SHA. Në mënyrë që të mos

ketë pengesa dhe paqartësi në nënshkrimin e kontratës mes fituesit të ankandit dhe Bashkisë Shkodër.

- *Në kushtet kur dokumentet e ankandit janë vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjore në kushtet kur ana juaj është bërë shkelje flagrante e ligjit kërkojmë nga ana juaj që të bëni ndryshimin e kriterëve të kualifikimit për procedurën e ankandit dhe të vendosen kriteret vetëm në përputhje me ligjin dhe VKM që regullon aktivitetin e ankandëve publike.*
- *Kërkojmë pranimin e ankesës dhe ndryshimin e dokumenteve të ankandit sipas konstatimeve tona.*

II.4. Në datën 02.03.2021 autoriteti shitës i ka kthyer përgjigje ankimesit me anë të së cilës ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.5. Në datën 05.03.2021 kandidati blerës ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ku përveç pretendimeve të paraqitura pranë autoritetit shitës si më sipër cituar parashtron edhe pretendime të tjera si më poshtë:

- *Ndërkohë që në përgjigjen e autoritetit shitës përcaktohet se shitja do të jetë totale duke përfshirë edhe të drejtat dhe detyrimet që klubi i futbollit Vllaznia ka ndaj të tretëve. Ky element në fakt nuk është përcaktuar në asnjë pikë të dokumenteve të ankandit. Përkundrazi autoriteti shitës në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr.9874 datë 14.02.2008 Për Ankandin Publik i ndryshuar i cili përcakton se: Metodat e përlllogaritjes së vlerës fillestare në ankandin publik Përcaktimi i vlerës fillestare të një objekti ankandi bazohet në Vlerën Aktuale Monetare (VAM), çmimet e tregut, të dhënat e INSTAT-it apo të organeve të tjera shtetërore. Në vlerën fillestare përfshihen edhe detyrimet fiskale që lidhen me natyrën e objektit. Mënyra e përlllogaritjes së vlerës fillestare do të përcaktohet në rregullat e ankandit publik.*

Të ndodhur në këto kushte duket qartë se vlera fillestare e ankandit nuk është 50,794,000 por disa herë më e lartë referuar detyrimeve fiskale që ka klubi i futbollit Vllaznia.

- *Po ashtu në vijim të kësaj shkelje VKM nr.1719 datë 17.12.2008 në kreun II pika 2 përcakton se : Vlera fillestare e ankandit publik është (VAM) vlera aktuale monetare e objektit të shitjes, duke përfshirë të gjitha detyrimet fiskale, që lidhen me natyrën e objektit të llogaritura nga autoriteti shitës përpara dërgimit për botim të njoftimit të ankandit.*
- *Në rastin konkret vlerësimi i fundit për vlerën fillestare është bërë në vitin 2017 (rreth katër vite më parë), ndërkohë që përcaktimi ligjor i mësipërm e ka të shprehur qartë se vlera fillestare duhet të jetë vlera aktuale.*

- Po ashtu sqarohet se vlera fillestare e publikuar nuk i përgjigjet as vlerës së përcaktuar nga raporti i vlerësimit të cilit Bashkia Shkodër i është referuar për zhvillimin e procedurës.
- Sipas vlerësuesve është konsideruar se bazuar në të dhënat deri në vitin 2017 vlera fillestare është 50,794,000 lek me kushtin që Bashkia Shkodër duhet të pakësoj kapitalin aksionar në vlerën 318,322,000 duke e ulur vlerën e kapitalit në minimumin e lejuar nga ligji prej 2,000,000 lekë si dhe duke marrë përsipër debinë në vlerën prej 146,028,107 lekë.
- Vetëm pas këtyre rregullimeve ekspertët kanë përdorur dy metodat e vlerësimit nga ku kanë dalë vlerat përkatëse në njërin metodë 39,742,000 (tabela 10 e raportit të vlerësimit) dhe me metodën tjetër në vlerën 61,847,000 lek (tabela 16 e raportit të vlerësimit). Po ashtu në dy tabelat përcaktohet qartë plotësimi i kushteve për pakësimin e kapitalit dhe marrjen përsipër të detyrimeve në mënyrë që vlera të dalë sipas tabelës së mësipërme mesatarja e të cilave është vlera fillestare e publikuar.
- Po ashtu sqarohet se sipas nenit 4/1 të ligjit nr.9874 datë 14.02.2008 përcaktohet se: Ky ligj zbatohet për shitjen nëpërmjet ankandit publik: a) të kuotave të pjesëmarrjes në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar apo aksionet për shoqëritë anonime (pa ofertë publike) për kontributet në natyrë; b) të mallrave ushqimore të blera me shumicë me fondet e Buxhetit të Shtetit; c) të vlerave (mallrave) materiale të dala jashtë përdorimit; ç) të objekteve të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e ngarkuara me ligj; d) të objekteve të përcaktuara me ligj të veçantë.
- Asnjë sqarim nuk është bërë për faktin se çfarë përfshin apo kush janë kontributet në natyrë të cilat kërkohet të tjetërsohen në formën e aksioneve. Një fakt i tillë e veson jo vetëm procedurën por edhe faktin se cili është ligji i zbatueshëm për shitjen e aksioneve të cilat nuk janë kontribute në natyrë.
- Duke pasur këto paqartësi konstatohet qartë se është shkelur neni 24 i ligjit nr.9874 datë 14.02.2008 Për ankandin publik i ndryshuar i cili parashikon se: Njoftimet që botohen, duhet të përfshijnë të gjitha informacionet, që u lejojnë kandidatëve të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e ankandit.
- Ajo që është më flagrante në lidhje me shkeljet e kryera nga ana e Bashkisë Shkodër është përzgjedhja e procedurës. Ndërkohë që këshilli i detyron Bashkinë Shkodër të përdorë procedurën e hapur të ankandit kjo e fundit në njoftimet dhe publikimet përkatëse i referohet kësaj procedure por çuditërisht vendos kritere dhe kushte siç parashikohen në nenin 19/1 të ligjit nr.9874 datë 14.02.2008 për ankandin publik i ndryshuar i cili përcakton se: Procedura me përzgjedhje të blerësve përdoret nga autoriteti shitës për të kryer një shitje, në rastet kur: a) objekti i shitjes, për shkak të karakterit të tij shumë të ndërlikuar ose të veçantë, mund t'u ofrohet një numri të kufizuar blerësish; b) për autoritetin shitës është më e leverdishme, fillimisht, të shqyrtojë kapacitetin dhe kualifikimet e kandidatëve blerës të interesuar dhe më pas të ftojë ata që kanë kualifikimet minimale specifike të caktuara të paraqesin ofertat.

- *Këtë fakt e konfirmon edhe vetë Bashkia Shkodër e cila në kthim përgjigje ndër të tjera përcakton se vendosja e kritereve është bërë duke kërkuar që autoriteti shitës të krijojë një panoramë mbi përvojën e mëparshme të kandidatëve blerës , eksperiencën e duhur për të përmbushur kontratën , mjetet e nevojshme financiare, kapacitetet njerëzore dhe eksperiencën e duhur në menaxhimin e aktiviteteve sportive.*
- *Pra në thelb autoriteti shitës është duke zhvilluar një procedurë me përzgjedhje të blerësit të cilën e maskon si procedurë e hapur.*
- *Në kushtet kur dokumentet e ankandit janë vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjore në kushtet kur ana juaj është bërë shkelje flagrante e ligjit kërkojmë nga ana juaj që të bëni ndryshimin e kritereve të kualifikimit për procedurën e ankandit dhe të vendosen kriteret vetëm në përputhje me ligjin dhe VKM që rregullon aktivitetin e ankandëve publike.*

II.6. Në datën 16.03.2021, nëpërmjet shkresës me nr. 4228/1 prot., datë 16.03.2021, autoriteti shitës ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin në lidhje me procedurën e mësipërme të ankandit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit shitës,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “*Si pasojë e kritereve të vendosura nga ana juaj, ajo që konstatohet menjëherë është shkelja e nenit 1/c për nxitjen e konkurrencës nëpërmjet subjekteve të interesuara pasi po të ishte bërë një verifikim paraprak në organet tatimore se cilat janë dhe sa është numri i bizneseve që kanë realizuar sponsorizime (përjashto ato që janë ortakë ose të angazhuar në një ekip tjetër të futbollit shqiptar) është shumë i vogël për të mos thënë nuk ekziston fare. Vendosja e këtyre kritereve nuk siguron trajtim të barabartë për të gjithë pasi favorizon në mënyrë direkte subjektet e preferuar nga ana juaj.*

Në pikën q të kërkesave për kualifikim është kërkuar që subjekti pjesëmarrës duhet të ketë kontrata transaksione dhe eksperiencë në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive , shoqërive sportive të futbollit apo sporteve të tjera të ngjashme, minimalisht në tre vitet e fundit pjesë e veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB. Nëse është përcaktuar shprehja minimalisht normalisht, që të sqarohet edhe e kundërta e saj. Po maksimalisht deri kur është e lejuar dhe e pranueshme për ju që të ekzistojë një eksperiencë e ngjashme. Pasi në interpretim literal të fjalës

Minimalisht i bie që të mos ketë ndonjë kufizim për periudhën se kur duhet të jetë realizuar eksperiencia e ngjashme.

Po ashtu është lënë në mënyrë evasive “përcaktimi i sporteve të ngjashme” duke mos sqaruar se cilin prej sporteve do e vlerësojë si të ngjashme Bashkia Shkodër apo thjesht do e bëj vlerësimin vetëm mbi baza subjektive duke favorizuar subjektin e saj preferencial.

Është kërkuar që të paraqiten dokumentacione sponsorizimi në përputhje me legjislacionin tatimor ndërkohë që legjislacioni tatimor e kushtëzon ruajtjen e dokumenteve kontabël tatimor për një periudhë 5-vjeçare. Duke sjellë përjashtimin automatik të subjekteve që kanë kryer sponsorizime në periudha më të largëta se 5 vite. Përpilimi i dokumenteve është bërë në mënyrë tendencioze duke lënë përshtypje sikur janë vendosur në dëm të ndonjë subjekti dhe jo në dobi të subjekteve të interesuara.

VKM nr.308 datë 10.04.2013 e ka të përcaktuar qartë dh) kriteret dhe kushtet për pjesëmarrje kualifikim dhe vlerësim të ofertës: Ky formular përmban listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti shitës, për të drejtën për të marrë pjesë në procesin e ankandit, në përputhje me nenin 29 dhe 30 të LAP-së. Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin, për të gjitha sa u thanë më sipër, një deklaratë me shkrim. Vërtetimi i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) do të jetë i barasvlershëm me vendimin për fitimin e personalitetit juridik, përcaktuar në nenin 29 të LAP-së. Kriteri bazë i vlerësimit do të jetë oferta me çmimin më të lartë.

Edhe në këtë përcaktim ligjor kuptohet qartë, se qëllimi i ankandit ka të bëjë vetëm me njohjen e personalitetit juridik të subjektit pjesëmarrës , ligjshmërinë e aktivitetit të tij dhe vendos si bazë të shpalljes fitues ofertën me çmim më të lartë.

Nuk është dhënë as ndonjë sqarim në lidhje me faktin se çfarë do të bëhet me detyrimet eventuale që mund të ketë shoqëria Klubi i Futbollit Vllaznia SHA. Në mënyrë që të mos ketë pengesa dhe paqartësi në nënshkrimin e kontratës mes fituesit të ankandit dhe Bashkisë Shkodër.

Në kushtet kur dokumentet e ankandit janë vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjore në kushtet kur ana juaj është bërë shkelje flagrante e ligjit kërkojmë nga ana juaj që të bëni ndryshimin e kriterëve të kualifikimit për procedurën e ankandit dhe të vendosen kriteret vetëm në përputhje me ligjin dhe VKM që rregullon aktivitetin e ankandëve publike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 5 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumenteve të ankandit, të procedurës objekt ankimi, autoriteti shitës ka kërkuar:

q) Për të vërtetuar se kandidati blerës është i kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë: Kontrata transaksione dhe eksperiencia në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo edhe sporte të ngjashme minimalisht në tre vitet e fundit, pjesë të veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB.

u) Sponsorizime të ngjashme në një vlerë prej 20,317,600 lekë (40% të vlerës fillestare të ankandit), të realizuara. Çdo sponsorizim rregullohet me kontratë të lidhur ndërmjet sponsorizuesit dhe përfituesit. Kryerja e çdo sponsorizimi në para a në natyrë dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël e bankar në fuqi. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të subjektit të paraqesë dokumente që vërtetojnë:

Sponsorizimet në favor të sporteve ekipore më të përhapura të destinuara për:

1. Evidentimin e talenteve dhe zhvillimin e sportistëve të rinj
2. Mbulimin e shpenzimeve të stafit sportiv
3. Përmirësimin dhe rinovimin e pasurive të luajtshme që i shërbejnë për aktivitetin sportiv
4. Zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive
5. Shpenzimet që kanë të bëjnë me trajtimin ose
6. Mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga organizimi i garave sportive

Dokumentet që vërtetojnë transferimin e shumës së sponsorizimit do të jenë aktmarrëveshje, vendime të këshillit bashkiak për donacione apo sponsorizime, dokumente bankare që vërtetojnë transferimin e shumave, fatura tatimore, akte dhurimi, procesverbale marrje në dorëzim, fletë hyrje etj., dokumente që parashikohen në legjislacionin e RSH tatimor kontabël e bankar në fuqi.

III.1.2. Në nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, të ligjit Nr.9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar parashikohet si më poshtë:

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për realizimin e shitjes publike nëpërmjet procedurës së ankandit nga autoriteti shitës dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të pjesëmarrësve në procedurën e ankandit.
2. Qëllime të këtij ligji janë:
 - a) rritja e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e ankandit publik, të kryera nga autoritetet shitëse;
 - b) nxitja e pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik;
 - c) nxitja e konkurrencës ndërmjet blerësve;
 - ç) sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e ankandit publik;

d) sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparencë në procedurat e ankandit publik.

III.1.3. Referuar sa më sipër, Komisioni vëren se autoriteti shitës në procedurën e ankandit objekt ankimi ka kërkuar nga ana e kandidatëve blerës të kenë kryer sponsorizime të ngjashme në një vlerë prej 20,317,600 lekë (40% të vlerës fillestare të ankandit), të realizuara. Çdo sponsorizim rregullohet me kontratë të lidhur ndërmjet sponsorizuesit dhe përfituesit. Kryerja e çdo sponsorizimi në para a në natyrë dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël e bankar në fuqi. Lidhur me këtë kriter ankimuesi në parashtrimet në ankesë pretendon se numri i bizneseve, që mund të kenë kryer sponsorizime të kësaj natyre është shumë i vogël për të mos thënë nuk ekziston fare. Lidhur me pretendimin e sipërcituar të kandidatit blerës, KPP thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit shitës për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së kandidatit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti shitës përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga kandidatët blerës pjesëmarrës në procedurat e ankandit. Vlen të theksohet, se ndryshe nga ligji për prokurimin publik, ligji i posaçëm për ankandet publike nuk parashikon asnjë dispozitë me anë të së cilës kufizon autoritet shitës të përcaktojnë kriteret e veçanta të kualifikimit, që gjykojnë se janë të nevojshme për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së kandidatit për përmbushje me sukses të kontratës, për sa kohë këto kritere nuk tejkalojnë objektin dhe volumin e saj.

Referuar nenit 2 të ligjit nr. 9874 datë 14.2.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar, Zhvillimi i procedurave të ankandive publike realizohet në përputhje me parimet e përgjithshme të mosdiskriminimit dhe trajtimi i barabartë i pjesëmarrësve në procedurat e ankandit publik, transparencë në procedurat e ankandit publik; barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve, që u ngarkohen pjesëmarrësve në procedurat e ankandit publik. Në tërësi, ligji për ankandin publik parashikon se në çdo procedurë, përfshirë edhe ato me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, autoritetit shitës duhet të sigurohet që të respektojë parimet e trajtimit të barabartë, të proporcionalitetit dhe të transparencës. Në këtë kuptim, KPP gjykon se autoriteti shitës të sigurojë që të ruhet ekuilibri (proporcioni) i nevojshëm midis interesit për përmbushjen me sukses të kontratës dhe interesave të operatorëve të mundshëm të kandidatëve blerës. Gjithashtu, nga ana tjetër, Komisioni mban në vëmendje edhe natyrën e veçantë të objektit të shitjes, aksionet e autoritetit shitës në masën 100 % në kapitalin e shoqërisë Klubit të Futbollit "VLLAZNIA" SHA. Në rastin konkret, me anë të kriterit të sipërcituar, autoriteti shitës kërkon të krijojë një panoramë mbi kapacitetet e kandidatëve blerës lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme me objektin e ankandit, në mënyrë që të krijojë bindjen se këta të fundit posedojnë eksperiencën e duhur për të përmbushur me sukses kontratën objekt ankandit, duke pasur parasysh që klubi i futbollit aksionet e të cilit kërkohet të shiten paraqesin një interes të veçantë për publikun.

Sa më sipër, për një gjykim të drejtë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues nga njëra anë dhe pretendimeve të autoritetit kontraktor nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test balancues proporcionaliteti. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme

për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Synimi i autoritetit kontraktor është të sigurohet që kandidati blerës disponon jo vetëm aftësinë paguese të nevojshme për përmbushjen e synimit të kontratës së shitjes së kuotave, por gjithashtu edhe kapacitetet e nevojshme, eksperiencën për menaxhimin (ex post) të kontratës, për vetë faktin se kemi të bëjmë me një aset të rëndësishëm publik, një klub sportiv me histori mbi 100 vjeçare në futbollin shqiptar. Parë në këtë aspekt autoriteti shitës ka përcaktuar edhe kriterin mbi disponimin e sponsorizimeve të ngjashme nga ana e kandidatëve blerës në masën sa 40 % e vlerës fillestare të ankandit, veçanërisht në fushën e sportit.

KPP pas shqyrtimit të pretendimeve të ankimuesit si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor gjykon se kriteri i veçantë i kualifikimit lidhur me sponsorizime të ngjashme në thelb nuk i shërben autoritetit shitës për krijimin e panoramës mbi kapacitetet e kandidatëve blerës në procedurën e ankandit objekt ankimi. Përkundrazi një kriter i kësaj natyre do të ndikonte në uljen e konkurrencës në radhët e kandidatëve blerës pasi subjektet që do të shfaqin aftësi për blerjen e aksioneve jo domosdoshmërisht duhet të kenë kryer sponsorizime të ngjashme. Ligji për sponsorizimet rregullon nga njëra anë fushën konkrete se ku mund të kryhen sponsorizimet si edhe avantazhet fiksale të subjekteve që kanë kryer sponsorizime. *Racio legis* e ligjit sektorial për sponsorizimet lidhet me nxitjen e veprimtarive sociale dhe publike ndërkohë që ligji ndalon sponsorizimet me qëllime të përfitimit ekonomik nga sponsorizuesi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri lidhur me sponsorizimet krijon efektin e kufizimit dhe të uljes së konkurrencës në radhët e subjekteve blerëse të interesuara në këtë procedurë, e cila në thelb ka për qëllim të sigurojë shitjen më optimale dhe të leverdishme për interesat publike. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti shitës duhet të marrë masa për heqjen e kriterit lidhur me sponsorizimet si një kriter i cili ndikon në uljen e konkurrencës në procedurën e ankandit objekt ankimi dhe në kundërshtim me parimet kryesore të ligjit të ankandit publik.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se *“në pikën q të kërkesave për kualifikim është kërkuar që subjekti pjesëmarrës duhet të ketë kontrata transaksione dhe eksperiencia në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo sporteve të tjera të ngjashme, minimalisht në tre vitet e fundit pjesë e veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB. Nëse është përcaktuar shprehja minimalisht normalisht që të sqarohet edhe e kundërta e saj. Po maksimalisht deri kur është e lejuar dhe e pranueshme për ju që të ekzistojë një eksperiencë e ngjashme. Pasi në interpretim literal të fjalës Minimalisht i bie që të mos ketë ndonjë kufizim për periudhën se kur duhet të jetë realizuar eksperiencia e ngjashme”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 5 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumenteve të ankandit, të procedurës objekt ankimi, autoriteti shitës ka kërkuar:

q) Për të vërtetuar se kandidati blerës është i kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë: Kontrata transaksione dhe eksperiencia në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo edhe sporte të ngjashme minimalisht në tre vitet e fundit, pjesë të veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB.

III.2.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit shitës drejtuar ankimuesit sqarohet se: *Shprehja minimalisht në tre vitet e fundit nuk përjashton por lejon pjesëmarrjen e të gjithë kandidatëve të cilët kanë realizuar sponsorizime në një periudhë edhe më të hershme se 3 vitet e fundit d.m.th. në një periudhë të pakufizuar në afat.*

Sa më sipër, KPP gjykon se në kushtet kur edhe vetë autoriteti kontraktor pranon se eksperiencia e ngjashme e kërkuar në kriterin e veçantë të kualifikimit nuk do të ketë një afat të caktuar si dhe meqenëse se dhe vetë ligji nuk parashikon kritere dhe afate strikte lidhur me kapacitete ekonomike që duhet të disponojnë kandidatët blerës në procedurat e ankandit publik, përcaktimi në kriterin e veçantë të kualifikimit minimum në tre vitet e fundit nuk ka asnjë efekt në rastin konkret. Për këtë arsye KPP gjykon se përcaktimi në tre vitet e fundit duhet të hiqet nga kriteri i veçante i kualifikimit me qëllim shmangien e konfuzionit në radhët e kandidatëve blerës, mjafton që këta të fundit të kenë kryer eksperiencia të ngjashme me objektin e ankandit pavarësisht kohës së kryerjes së tyre. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti shitës duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit duke hequr përcaktimin minimalisht tre vitet e fundit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se *“Po ashtu është lënë në mënyrë evasive “përcaktimi i sporteve të ngjashme” duke mos sqaruar se cilin prej sporteve do e vlerësojë si të ngjashme Bashkia Shkodër apo thjesht do e bëjë vlerësimin vetëm mbi baza subjektive duke favorizuar subjektin e saj preferencial”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 5 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumenteve të ankandit, të procedurës objekt ankimi, autoriteti shitës ka kërkuar:

q) Për të vërtetuar se kandidati blerës është i kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë: Kontrata transaksione dhe eksperiencia në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo edhe sporte të ngjashme minimalisht në tre vitet e fundit, pjesë të veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB.

III.3.2. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit shitës drejtuar ankimuesit lidhur me kriterin sa më sipër sqarohet se: *Për sa i takon komentit në lidhje me sporte të ngjashme ju sqarojmë se nga konsultimet e bëra prioritet ka qenë që subjektet që do të paraqesin ofertat e tyre duhet që të pranohen edhe ato që kanë kontribuar në sportet ekipore më të përhapura në qytetin e Shkodrës dhe më gjerë. Kjo përkon pikërisht me zbatimin e parimit të barazisë dhe ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë ato të cilët kanë kontribuar në drejtim të financimit sponsorizimit, bashkëpunimit ose menaxhimit të klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo për sportet*

e tjera të ngjashme ekipore. Në kuptimin e mësipërm në sporte të ngjashme përfshihen të gjitha sportet ekipore më të përhapura.

III.3.3. Në nenin 27 të ligjit të ligjit Nr.9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar parashikohet si më poshtë: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për objektin që do të shitet me ankand publik nga autoriteti shitës, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë 17 për sqarim të dokumenteve të ankandit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'u komunikojë sqarimin përkatës të gjithë kandidatëve të tjerë, që kanë tërhequr dokumentet e ankandit. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik. 2. Autoriteti shitës, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave të ankandit dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një kandidat, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e ankandit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve blerës, që kanë tërhequr dokumentet e ankandit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. Në çdo rast, autoriteti shitës e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 5 ditë. 3. Autoriteti shitës, gjatë takimit me kandidatët blerës, duhet të mbajë procesverbal, ku përfshihen edhe kërkesat e dorëzuara gjatë takimit për sqarime për dokumentet e ankandit, si dhe përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, por, në çdo rast, pa identifikuar burimet e tyre.*

III.3.4. Sa më sipër, KPP gjykon se ankimuesi është i paqartë lidhur me faktin se cila kategori sporti do të konsiderohet sport i ngjashëm në përmbushjen e kriterit lidhur me eksperiencën e ngjashme të kërkuar. Ndërkohë që autoriteti shitës në kthim-përgjigjen drejtuar ankimuesit, ka sqaruar se në sporte të ngjashme përfshihen të gjitha sportet ekipore më të përhapura. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në sqarimin e dhënë në kthim përgjigje sërish nuk jep informacion konkret lidhur me kategorinë e sporteve të ngjashme të cilat kandidatët blerës duhet të dëshmojnë se kanë realizuar në procedurën e ankandit objekt ankimi. Për këtë arsye, KPP gjykon se autoriteti kontraktor referuar edhe legjislacionit sektorial e konkretisht ligjit për sportin, duhet të marrë masa për sqarimin e kriterit duke përcaktuar qartë dhe saktë se cila kategori e sportit do të konsiderohet e ngjashme në procedurën e ankandit objekt ankimi duke shmangur kështu konfuzionin në radhët e kandidatëve blerës dhe njëherazi të njësisë së ankandit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit që do të paraqitet nga kandidatët blerës në procedurën e ankandit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Nuk është dhënë as ndonjë sqarim në lidhje me faktin se çfarë do të bëhet me detyrimet eventuale që mund të ketë shoqëria Klubi i Futbollit Vllaznia

SHA. Në mënyrë që të mos ketë pengesa dhe paqartësi në nënshkrimin e kontratës mes fituesit të ankandit dhe Bashkisë Shkodër, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit shitës lidhur me sa më sipër sqarohet se: *Detyrimet ndaj të tretëve të shoqërisë Klubi i Futbollit Vllaznia SHA i përkasin të drejtave dhe detyrimeve që ky subjekt duhet të përmbushë në raport me të tretët. Autoriteti Shitës në DSA ka pasqyruar linkun me të dhënat e pasqyrave financiare dhe raportet përkatëse të auditimit në faqen web www.bashkiashkodër.gov.al ku mund të infomoheni në lidhje me gjendjen financiare të shoqërisë. Në ballinën e faqes web të Bashkisë Shkodër ... është informacioni i plotë financiar, i pasqyruar në pasqyrat financiare të viteve pjesë e relacionit të miratuar me vendim nr.54 datë 27.11.2020 Për miratimin për shitje me ankand të aksioneve të klubit të futbollit Vllaznia SHA në masën 100%. Me këtë vendim këshilli bashkiak ka miratuar tjetërsimin e shoqërisë aksionere me të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas pasqyrave financiare.*

III.4.2. Në nenin 27 të ligjit të ligjit Nr.9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar parashikohet si më poshtë: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për objektin që do të shitet me ankand publik nga autoriteti shitës, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të ankandit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'u komunikojë sqarimin përkatës të gjithë kandidatëve të tjerë, që kanë tërhequr dokumentet e ankandit. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik. 2. Autoriteti shitës, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave të ankandit dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një kandidat, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e ankandit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve blerës, që kanë tërhequr dokumentet e ankandit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. Në çdo rast, autoriteti shitës e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 5 ditë. 3. Autoriteti shitës, gjatë takimit me kandidatët blerës, duhet të mbajë procesverbal, ku përfshihen edhe kërkesat e dorëzuara gjatë takimit për sqarime për dokumentet e ankandit, si dhe përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, por, në çdo rast, pa identifikuar burimet e tyre.*

III.4.3. Sa më sipër, KPP gjykon se pretendimet e ankimuesit për mungesë të një informacioni kyç lidhur me objektin e shitjes e konkretisht të drejtat dhe detyrimet, që ekzistojnë mbi objektin e ankandit janë të drejta. Autoriteti shitës në kthim-përgjigje sqaron, se objekti që do të nënshtrohet shitjes do të përfshijë të gjitha të drejtat dhe detyrimet duke bërë një referim të thjeshtë në faqen web www.bashkiashkodër.gov.al, ku sqaron se kandidatët mund të informohen në lidhje me gjendjen financiare të shoqërisë. Në vlerësimin e KPP ky informacion dhe referimi në faqen web

të autoritetit shitës, nuk është i mjaftueshëm që kandidatët të krijojnë një panoramë të qartë mbi detyrimet dhe të drejtat që ka aktualisht klubi i futbollit kundrejt të tretëve. KPP sjell në vëmendje të autoritetit shitës nenin 12 të LAP i cili parashikon se :

1. *Identifikimi i objektit të shitjes bëhet nga autoriteti shitës që do të realizojë procedurën e shitjes me ankand. Autoriteti shitës përcakton karakteristikat e objektit që do të shitet, duke përshkruar atë sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, për të krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.*
2. *Informacionet për objektin që do të shitet duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në ankandin publik.*
3. *Informacioni i autoritetit shitës duhet të përshkruajë qartë objektin që do të shitet me ankand publik, duke iu referuar aktit të pronësisë mbi objektin apo aktit ligjor të disponibilitetit të tij.*
4. *Objekti duhet të përshkruhet në përputhje me standardet e vlerësimit sipas sasisë, çmimit për njësi dhe çmimit në total, metodologjisë së përdorur për vlerësimin e objektit të shitjes, kur këto janë kryer sipas standardeve të caktuara kombëtare apo ndërkombëtare.*
5. *Objekti duhet të shoqërohet, kur është e nevojshme, edhe me genplane, planimetri të objektit, vizatime, modele, makete, mostra, fotografi, analiza kimike etj. Nga përshkrimi duhet të dalë gjendja funksionale e objektit të shitjes nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale.*

Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti shitës duhet të japë informacionin e plotë për të gjithë kandidatët blerës, të ofrojë të gjithë dokumentacionin financiar me qëllim, që kandidatët të jenë tërësisht të qartë mbi të drejtat dhe detyrimet që klubi ka kundrejt të tretëve. Mospërcaktimi i saktë i informacionit në lidhje me këto elementë apo përcaktimi i të dhënave kontradiktore, do të krijojë kushte për konfuzion tek kandidatët blerës lidhur me mënyrën e ofertimit të tyre në kundërshtim me frymën e ligjit i cili kërkon trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit në procedurat e ankandit publik.

Për sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara pranë KPP-së se: *Ndërkohë që në përgjigjen e autoritetit shitës përcaktohet se shitja do të jetë totale duke përfshirë edhe të drejtat dhe detyrimet që klubi i futbollit Vllaznia ka ndaj të tretëve. Ky element në fakt nuk është përcaktuar në asnjë pikë të dokumenteve të ankandit. Përkundrazi autoriteti shitës në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr.9874 datë 14.02.2008 Për Ankandin Publik i ndryshuar i cili përcakton se: Metodatat e përllogaritjes së vlerës fillestare në ankandin publik , përcaktimi i vlerës fillestare të një objekti ankandi bazohet në Vlerën Aktuale Monetare (VAM), çmimet e tregut, të dhënat e INSTAT-it apo të organeve të tjera shtetërore. Në vlerën fillestare përfshihen edhe detyrimet*

fiskale që lidhen me natyrën e objektit. Mënyra e përlllogaritjes së vlerës fillestare do të përcaktohet në rregullat e ankandit publik. Të ndodhur në këto kushte duket qartë se vlera fillestare e ankandit nuk është 50,794,000 por disa herë më e lartë referuar detyrimeve fiskale që ka klubi i futbollit Vllaznia.

Po ashtu në vijim të kësaj shkeljeje VKM nr.1719 datë 17.12.2008 në kreun II pika 2 përcakton se : Vlera fillestare e ankandit publik është (VAM) vlera aktuale monetare e objektit të shitjes, duke përfshirë të gjitha detyrimet fiskale, që lidhen me natyrën e objektit të llogaritura nga autoriteti shitës përpara dërgimit për botim të njoftimit të ankandit. Në rastin konkret vlerësimi i fundit për vlerën fillestare është bërë në vitin 2017 (rreth katër vite më parë), ndërkohë që përcaktimi ligjor i mësipërm e ka të shprehur qartë se vlera fillestare duhet të jetë vlera aktuale. Po ashtu sqarojmë se vlera fillestare e publikuar nuk i përgjigjet as vlerës së përcaktuar nga raporti i vlerësimit të cilit Bashkia Shkodër i është referuar për zhvillimin e procedurës. Sipas vlerësuesve është konsideruar, se bazuar në të dhënat deri në vitin 2017 vlera fillestare është 50,794,000 lekë me kushtin që Bashkia Shkodër duhet të pakësojë kapitalin aksionar në vlerën 318,322,000 lekë, duke e ulur vlerën e kapitalit në minimumin e lejuar nga ligji prej 2,000,000 lekë si dhe duke marrë përsipër debinë në vlerën prej 146,028,107 lekë. Vetëm pas këtyre rregullimeve ekspertët kanë përdorur dy metodat e vlerësimit nga ku kanë dalë vlerat përkatëse në njërin metodë 39,742,000 (tabela 10 e raportit të vlerësimit) dhe me metodën tjetër në vlerën 61,847,000 lekë (tabela 16 e raportit të vlerësimit). Po ashtu në dy tabelat përcaktohet qartë plotësimi i kushteve për pakësimin e kapitalit dhe marrjen përsipër të detyrimeve në mënyrë që vlera të dalë sipas tabelës së mësipërme, mesatarja e të cilave është vlera fillestare e publikuar.

Po ashtu sqarojmë, se sipas nenit 4/1 të ligjit nr.9874 datë 14.02.2008 përcaktohet se: Ky ligj zbatohet për shitjen nëpërmjet ankandit publik: a) të kuotave të pjesëmarrjes në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar apo aksionet për shoqëritë anonime (pa ofertë publike) për kontributet në natyrë; b) të mallrave ushqimore të blera me shumicë me fondet e Buxhetit të Shtetit; c) të vlerave (mallrave) materiale të dala jashtë përdorimit; ç) të objekteve të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e ngarkuara me ligj; d) të objekteve të përcaktuara me ligj të veçantë.

Asnjë sqarim nuk është bërë për faktin se çfarë përfshin apo kush janë kontributet në natyrë të cilat kërkohet të tjetërsohen në formën e aksioneve. Një fakt i tillë e veson jo vetëm procedurën por edhe faktin se cili është ligji i zbatueshëm për shitjen e aksioneve të cilat nuk janë kontribute në natyrë.

Duke patur këto paqartësi konstatohet qartë, se është shkelur neni 24 I ligjit nr.9874 datë 14.02.2008 Për ankandin publik i ndryshuar i cili parashikon se: 'Njoftimet që botohen, duhet të përfshijnë të gjitha informacionet, që u lejojnë kandidatëve të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e ankandit.' Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se parashtrimet më sipër në thelb kanë të bëjnë me një moment për të cilin ankimesi nuk është dakord e konkretisht me mënyrën e përlllogaritjes nga ana e autoritetit shitës të vlerës fillestare të ankandit (VAM).

III.5.1. KPP vëren se lidhur me këtë fakt ankimesi në parashtrimet në ankesën drejtuar autoritetit shitës ka pretenduar se nuk është dhënë as ndonjë sqarim në lidhje me faktin, se çfarë do të bëhet me detyrimet eventuale që mund të ketë shoqëria Klubi i Futbollit Villaznia SHIA, në mënyrë që të mos ketë pengesa dhe paqartësi në nënshkrimin e kontratës mes fituesit të ankandit dhe Bashkisë Shkodër. Për këtë pretendim sikundër arsyetuar më lart KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të vendosë në dispozicion të të gjithë kandidatëve informacionin e nevojshëm.

III.5.2. Ndërkohë në parashtrimet në ankesën drejtuar KPP, ankimesi shkon më tej duke shfaqur mosdakordësi lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së vlerës fillestare të ankandit publik (VAM). KPP e gjen këtë pretendim të ankimesit në mosrespektim të shkallëve të ankimit në kundërshtim me nenin 42 të LPA i cili parashikon shprehimisht se : *“Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të ankandit, kur gjykon se një vendim i autoritetit shitës është marrë në kundërshtim me këtë ligj apo me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. 2. Ankesa i paraqitet me shkrim autoritetit shitës brenda 7 ditëve nga data kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji. 3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti shitës pezullon vazhdimin e procedurës së ankandit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni. 4. Autoriteti shitës shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës. 5. Nëse autoriteti shitës nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti shitës, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti shitës. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit shitës. “Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkëljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit shitës. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, me Kodin e Procedurave Administrative dhe me 25 rregullat e ankandit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme.*

Kandidati blerës, në respektim të shkallëve të ankimit, duhet të paraqesë paraprakisht ankesë pranë autoritetit kontraktor për të gjitha pretendimet (pra edhe lidhur me vlerën fillestare të ankandit) lidhur me procedurën e ankandit ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e ankandit publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankesë pranë autoritetit shitës. Objekti i ankesës së paraqitur pranë autoritetit shitës në respekt të shkallëve të ankimit nuk mund të shtohet në momentin e paraqitjes në KPP. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për shkak të ligjit (*ipso*

lege), pretendimet e ankimuesit të cilat nuk janë ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor, nuk mund të merren në shqyrtim nga KPP.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Vendos

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga kandidati blerës “Colosseo Construction” SHPK për procedurën e ankandit “Procedurë e hapur”, me objekt “Bashkia Shkodër shet me procedurë ankandi aksionet e Klubit të Futbollit “VLLAZNIA” SHA, në masën 100%.”, me vlerë fillestare 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.03.2021, nga autoriteti shitës Bashkia Shkodër.
 2. Autoriteti shitës të modifikojë dokumentet e procedurës së ankandit, në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti shitës, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga kandidati blerës “Colosseo Construction” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 392 Protokoli, Datë 05.03.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj



